

DERISA TË GJITHË FËMIJËT
TË SHËROHEN

Për trajtimin me respekt

Të dashur paciente dhe pacientë,
të dashur prindër, të afërm dhe vizitorë

Ju urojmë mirëseardhjen në spitalin pediatrik universitar të Zyrgut!

Një fëmijë i sëmurë ose i lënduar është një sfidë e madhe si për fëmijën tuaj, ashtu edhe për ju dhe personat përreth. Ne duam që ta trajtojmë njëri-tjetrin me respekt, fleksibilitet dhe gatishmëri për të ndihmuar.

Specialistët janë përgjegjës për përkujdesjen dhe trajtimin e fëmijës suaj. Ata janë të trajnuar posaçërisht për nevojat e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Duam t'ju përfshijmë në trajtimin dhe përkujdesjen e fëmijës suaj dhe t'ju mbajmë të informuar. Nëse keni pyetje, drejtojuni mjekes, mjekut ose infermierit tuaj.

Vlerat e mëposhtme janë të rëndësishme për ne në bashkëpunimin me ju:

- Ne jemi respektues, të përgjegjshëm dhe mbështetës me njëri-tjetrin.
- Ne i respektojmë të gjithë njerëzit, pavarësisht gjinisë, fesë, origjinës, statusit social, gjuhës dhe stilit të jetesës.
- Ne nuk tolerojmë asnjë formë agresiviteti, dhune, ngacmimi apo kërcënimi.
- Nëse vlerat tona shkelen, do të marrim masa për mbrojtjen e pacienteve dhe pacientëve tanë, familjeve të tyre dhe personelit.

Vëmendja dhe preokupimi juaj është për fëmijën tuaj dhe kjo është e rëndësishme.

Vëmendja dhe përgjegjësia jonë është për të gjithë fëmijët.

Ju lutemi ta mirëkuptoni këtë!

Qëllimi ynë është të kujdesemi në mënyrë të sigurt për të gjithë pacientet dhe pacientët.

Për këtë arsye, ju lutemi të

respektoni rregullat e mëposhtme:

- Ndiqni udhëzimet e personelit.
- Respektoni rregullat dhe rutinën e përditshme të spitalit.
- Respektoni takimet e planifikuara.
- Ndërhyni në trajtimin e fëmijës suaj, vetëm atëherë kur jeni udhëzuar prej nesh (p.sh. për përdorimin e pajisjeve mjekësore, për dhënien e ilaçeve).
- Mund të filmoni apo të fotografoni vetëm fëmijën tuaj, asnjë person apo pajisje tjetër.
- Ndalohet instalimi i pajisjeve tua personale për mbikëqyrjen e fëmijës (fotografi, filma, tinguj).

Për më shumë detaje, vizitoni www.kispi.uzh.ch/respektvoll

Ju falënderojmë për besimin tuaj dhe ju urojmë nga zemra gjithë të mirat juve, fëmijës dhe familjes suaj!

